



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
DREJTORIA E KURRIKULAVE, SIGURIMIT TË CILËSISË DHE
KËRKIMIT SHKENCOR

MIRATOHET

REKTORI

Prof. dr. Ali JASHARI



PLANI I VEPRIMIT PËR ZHVILLIMIN E SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

Në zbatim të VKM nr. 783, datë 26.12.2018, "Për vlerësimin e performancës në mësimdhënie të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë, edhe nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve", si dhe të shkresës me nr. 5/52 prot. datë 1.3.2019 "Për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve", Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor, ka hartuar planin e veprimit për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar Studentor.

Përshkrim i veprimtarive dhe detyrave:

Në kuadër të zhvillimit të Sondazhit Kombëtar Studentor, në bazë të përcaktimeve të veprimtarive dhe afateve të përcaktuara nga ASCAL, do të zhvillohen veprimtari mbështetëse për zbatimin e kërkesave të përcaktuara në shkresën me nr. 5/52 prot. datë 1.3.2019 "Për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve". Veprimtari të kryesore që do të zhvillohen në vazhdim lidhen kryesisht me:

- Ngritjen e grupeve për koordinimin e procesit dhe grupit teknik që do të njoftojnë studentët për plotësimin e sondazhit.
- Përcaktimin e detyrave të grupeve.
- Nxjerrjen e të dhënave (Emër, Mbiemër, Adresë elektronike) për të gjithë studentët e UNIKO dhe dërgimi në ASCAL nëpërmjet AMS.
- Trajnimi i grupit teknik nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).
- Zhvillimi i takimit të Përfaqësuesve të ASCAL me studentët e UNIKO.
- Shpërndarja e pyetësorit nga ASCAL dhe njoftimi i studentëve nga grupi teknik.
- Hartimi i raportit nga ASCAL (rekomandimet)
- Hartimi i strategjisë për përmirësim pas Sondazhit Kombëtar Studentor nga NJSBC e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë

Përcaktimi i detyrave të grupeve:

Grupi i NJSBC do të angazhohet në hartimin e strategjisë për përmirësim pas publikimit të raportit të sondazhit nga ASCAL.

Grupi teknik do të angazhohet në disa detyra:

- Në nxjerrjen e adresave elektronike, filtrimin dhe rishikimin e adresave të pasakta.
- Në procesin e njoftimit të studentëve për plotësimin e sondazhit pas shpërndarjes.

PLANI I VEPRIMIT PËR ZHVILLIMIN E SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

NR.	VEPRIMTARIA	PËRGJEGJËSIT	PROCEDURA	AFATE	SHËNIME
1.	Ngritja e grupeve të punës	Rektori	Ngritja e grupeve të punës për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar Studentor	Brenda datës 8.3.2019	- Grupi i NJSBC - Grupi teknik Detyrat e grupeve të punës janë përcaktuar në planin e veprimit
2.	Dërgimi i të dhënave për grupet e punës dhe kontaktet e kryetarit të Këshillit studentor në AMS	Koordinatori Institucional	Krijimi i shërbimit në AMS dhe ngarkimi i të dhënave.	Brenda datës 8.3.2019	Në shërbim do të përfshihen edhe të dhëna të tjera që do të kërkohen nga ASCAL.
3.	Përcaktimi i detyrave të grupeve	Koordinatori Institucional	Përcaktimi i detyrave të grupeve të ngritura për çështjet teknike të procesit dhe strategjisë për përmirësim në kuadër të sigurimit të cilësisë.	Brenda datës 8.3.2019	Sipas planit të veprimit.
4.	Nxjerrja e adresave elektronike të studentëve,	Grupi teknik për zhvillimin e pyetësorit	Do të shkarkohen adresat elektronike për të gjithë studentët	Brenda datës 11.3.2019	Nga STIS
5.	Filtrimi dhe rishikimi i adresave të pasakta.	Grupi teknik për zhvillimin e pyetësorit	Do të bëhet filtrimi dhe rishikimi i tyre.	Brenda datës 19.3.2019	Nga Specialistet e TI në fakultete
6.	Dërgimi i adresave elektronike të studentëve	Koordinatori Institucional	Dërgimi nëpërmjet AMS i adresave elektronike të studentëve.	Brenda datës 20.3.2019	KI dërgon në ASCAL të dhënat sipas formatit të përcaktuar nga këta të fundit
7.	Zhvillimi i trajnimeve nga ASCAL	ASCAL, Grupi teknik për zhvillimin e pyetësorit	Zhvillimi i trajnimeve në UNIKO për Grupin teknik për zhvillimin e pyetësorit ku do të trajnohen për procedurën e zhvillimit të sondazhit.	Sipas kalendarit të ASCAL	Trajnimet do të zhvillohen në varësi të kalendarit që do të dërgojë ASCAL.
8.	Zhvillimi i takimit ASCAL dhe studentë	ASCAL, Studentë	Zhvillimi i takimit të përfaqësuesve të ASCAL me Studentë		
9.	Shpërndarja e pyetësorit dhe njoftimi	ASCAL, KS, Grupi teknik për zhvillimin e pyetësorit	Shpërndarja e pyetësorit nga ASCAL dhe njoftimi i studentëve nga grupi teknik dhe këshilli studentor për një përqindje të lartë plotësimi.	Sipas kalendarit të ASCAL	Përdorimi i mjeteve të ndryshme të shpërndarjes së njoftimit

10.	Analiza dhe raporti i sondazhit	ASCAL	Hartimi i raportit të sondazhit nga ASCAL	Sipas afateve në kalendarin e ASCAL	
11.	Shqyrtimi i raportit dhe nxjerrja e detyrave	Grupi i NJSBC	Pas prezantimit të rezultateve dhe rekomandimeve të raportit nga ASCAL do të diskutohet nga NJSBC dhe do të nxirren detyrat / çështjet për përmirësim në vazhdim.	Pas publikimit të raportit të sondazhit	Sugjerohet që për çdo rekomandim të hartohen plane veprimi dhe strategji përmirësimi duke e ndjekur hap pas hapi.

Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor
Artur Prifti

SHKURTESA:

UNIKO – Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë;

ASCAL – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë;

AMS – Sistemi i Menaxhimit të të Dhënave të ASCAL

STIS – Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës;

NJSBC – Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;

KI – Koordinator i Institucional

TI – Teknologjisë së Informacionit

KS – Këshilli Studentor